



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 61 datë 26.10. 2020

**“Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit “ Përmirosimi i kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndertim të ri ” i hartuar nga Komisioni i Strehimit i ngritur me VKB nr 55 datë 25.09.2020.**

Në mbështetje të nenit 24, pika 2, neni 54 gërma “ k” e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ; Ligji nr 22/2018 “ Për strehimin social”, neni 15 dhe neni 16, me propozimin e Komisionit të Strehimit i ngritur me VKB nr 55 datë 25.09.2020;

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Miratimin e sistemit të pikëzimit , i cili do përdoret për përzgjedhjen e subjekteve apo familjeve përfituese të programit **“Përmirosimi i kushteve të banesave ekzistuese, deri ne një ndertim të ri”, bashkëlidhur .**
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”

ZV/KRYETAR

Ervis Shinoj

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Arbëri Qelçy

Miratuar me 24 vota

Vota Pro 24

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me Datë 30.10.2020

7.2. Numri total i pikëve është 100 pikë.

7.3. Tabela nr. 1 - Formula e Pikëzimit për aplikantët në programin e strehimit social “Programi të përmirsimin e kushteve të banesave ekzistuese , deri në një ndërtim të ri ”.

| <b>SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT TË<br/>“PËRMIRËSIMIT TË KUSHTEVE TË BANESAVE EKZISTUESE, DERI NË<br/>NJË NDERTIM TË RI”</b> |  |              |                                    |
|--|--|--------------|------------------------------------|
| <b>Nr.</b>   | <b>KRITERET E PIKËZIMIT</b>  | <b>PIKËT</b> | <b>Pikët e mbledhura</b>           |
| <b>1.1</b>   | <b>KUSHTET E STREHIMIT</b>   | <b>20</b>    | <i>Shëno vetëm 1 nga kriteret.</i> |
| A  | Nuk disponojnë banesë nëpronësi  | 0            |                                    |
| B  | Banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembje;   | 7            |                                    |
| C  | Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi   | 0            |                                    |
| Ç  | Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore,  | 3            |                                    |
| D  | Familje ose individë që humbasin banesës e tyre si pasojë e zhvendosjes ose zbatimi të një vendimi gjyqësor  | 0            |                                    |
| DH   | Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike   | 0            |                                    |
| E  | Objekte /banesa e amortizuara që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmiresime të domosdoshme  | 5            |                                    |
| F  | Rregullimin e banesave individuale ose strukturave, të cialt klasifikohen si banesë nën normen e strehimit dhe vetë familjet nuk sigurojnë të ardhurat e nevojshme për ta kryer vetë përmirsimin | 5            |                                    |
| <b>1.2</b>   | <b>KUSHTET FAMILJARE</b>   | <b>10</b>    | <i>Shëno</i>                       |

|            |   |           | <i>vetëm 1 nga kriteret.</i>            |
|------------|---|-----------|---|
| A          | Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë, kur përfshihen dhe vajzat nëna;   | 4         |   |
| B          | Të moshuarit që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;                 | 2         |   |
| C          | Familjet me më shumë se katër fëmijë;   | 3         |   |
| Ç          | Bashkëshortët, moshë e përgjithshme e përbashkët e të cilëve arrin deri në 60 vjeç;   | 1         |   |
| <b>1.3</b> | <b>KUSHTET SOCIALE</b>  | <b>40</b> | <b><i>Shëno deri në 3 kriteret.</i></b> |
| A          | Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;   | 6         |   |
| B          | Individë me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç;   | 5         |   |
| C          | Familje e mbetur e pastrehë përshkak të lirimimit të banesave të ish-pronarëve.   | 0         |   |
| Ç          | Emigrant të rikthyer, punëtorë emigrantë, azilkërkues, familje që në përbërje të tyre kanë persona të cilët gëzojnë statusin e ish të përndjekurit politik. | 1         |   |
| D          | Familjet e policëve të rënë në detyrë.  | 4         |   |
| DH         | Punonjësi reparteve FNSH dhe RENE, Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;  | 1         |   |
| Ë          | Viktima të dhunës në familje.   | 5         |   |
| F          | Viktimë e trafikimit ose viktimë e mundshmetëtrafikimit.  | 5         |   |
| G          | Anëtarë të komunitetit Rom  | 3         |   |

|            |   |           |                                    |
|------------|---|-----------|------------------------------------|
| GJ         | Anëtarë komunitetit Egjiptian   | 3         |                                    |
| H          | I mitur në konflikt me ligjin sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur, pas ekzekutimit të dënimit.                 | 1         |                                    |
| I          | Vajzë Nënë pas daljes nga programi I banesave sociale te specializuara  | 5         |                                    |
| J          | Individë që i përket komunitetit LGBTI, i cili ka një vendim të organit kompetent si viktimë e orientimit seksual ose identitetit gjinor. | 1         |                                    |
| <b>1.4</b> | <b>KUSHTET EKONOMIKE</b>  | <b>30</b> | <i>Shëno vetëm 1 nga kriteret.</i> |
| A          | Të ardhura nën 70% të të ardhurave mesatare.  | 25        |                                    |
| B          | Të ardhura 70%-100% të të ardhurave mesatare.   | 3         |                                    |
| C          | Të ardhura 100%-120% të të ardhurave mesatare.  | 2         |                                    |

### Mënyra e llogaritjes:

- I. Pikët maksimale të çdo sistem pikëzimi është 100.
- II. Nuk mund të mbliidhen brenda për brenda një kriteri pikët:

1. Kriterit 1.1-Kushtet e strehimit

2 .Kriterit 1.2-Kushtet familjare

3. Kriterit 1.4-Kushtet ekonomike.

4.Pikët nga A deri në fund të kriterit **1.3 Kushtet sociale**, mund të mbliidhen bashkë deri në tre gërma.

Familjet/individët që dalin përfitues nga aplikimet e kryera në afatin kohorë Tetor-Nëntor 2020 janë të vlefshme deri në fillim të muajit Korrik 2021. Në rast së këto banore përfitues me vendim të Këshillit Bashkiak nuk e marrin shërbimin për nderhyrjen në përmiresim të banesës së tyre deri në muajin Korrik 2021, për shkak të mungesës së fondeve dhe kapacitetit të Bashkisë për të ofruar këtë shërbim, ketyre banoreve ju lind detyrimi që të bejnë përditësimin dhe

rifreskimin e dokumentacioneve sipas procedurave te shpallura nga zyra që mbulon çeshtjet e strehimit social.

Në mënyre që të rifuten në procedure, dhe të rishpallën përfitues nëse plotësojnë kushtet pas perditësimit të të dhenave dhe dokumentacioneve keto familje i bashkohen familjeve të tjera aplikuese dhe përfitese që janë bërë gjate vitit pasardhes, dhe të gjithë familjet si ato të kualifikuara për tu trajtuar vitin parardhes si ato familje aplikuese ne vitin pasardhës te cilat kualifikohen si përfituese pasi plotësojnë kushtet për ku trajtuar nga ky program , futen në proces vlersimi sipas sistemit të pikëzimi duke u renditur për tu trajtuar sipas rendit të pikëve të sistemi i cili miratohet cdo vit nga këshilli bashkiak. Pra, familjet të cilat janë kualifikuar në vitin paraardhes dhe nuk kanë marrë shërbim dhe familjet aplikuese në vitin pasardhës që do rezulojnë përfitues sipas kushteve dhe kriterëve të ligjislacionit në fuqi, listat përfituese përfurnimtare do të miratohen përseri nga Këshilli i Bashkise Vau Dejës.

“Ky kufizim kohorë i fuqisë së aplikimit për banoret përfitues bëhet me qëllim vendosjen e një barazie midis aplikuesve, sepse çdo vit miratohet një sistem i ri pikëzimi dhe prioritetet në shtresat vulnerabël mund të ndyshojnë në pikëzim sipas kërkesave, gjithashtu mund të ndryshojnë kushtët e përfitimit si gjendje ekonomike etj ”.

ZV/KRYETAR

Ervis Shimoj



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Artaq Çelepyz

